



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
SHËRBIMI I PROVËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

**R A P O R T**  
**PËR MUAJIN MAJ 2011**

**E nderuar Zonja Zëvendësministre,**

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Maj 2011.

## **I. Statistika**

Për periudhën 01-31 Maj 2011, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka qenë i madh, duke marrë parasysh faktin që numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01- 31 Maj 2011, statistikat rezultojnë si më poshtë:

### **1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat.**

**Numri total i të dënuarve me dënime alternative që janë mbikëqyrrur nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën, nga data 01.06.2009 deri më datë 31.05.2011, është 3480 të dënuar.**

Nga 01.06.2009 - 31.05.2011, kanë përfunduar periudhën e provës nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës **424** të dënuar, pra ka përfunduar me sukses procesi i mbikëqyrjes për ta.

Kështu numri total i të dënuarve që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (duke zbritur numrin e atyre që kanë përfunduar dënimin alternativ) është **3056 të dënuar.**

I ndarë sipas Zyrave Vendore (duke llogaritur dhe të dënuarit që kanë përfunduar dënimin alternativ):

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **1242** të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **281** të dënuar me dënime alternative.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **459** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **465** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Lezhë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **195** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Elbasan mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **159** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Korçë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **182** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Gjirokastrë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **73** të dënuar me dënime alternative.
2. *Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.*

Sa më sipër duke ju referuar numrit total të të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **3056** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel vendi aktualisht është **102**. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje **124** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje **94** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje **77** të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje **155** të dënuar për çdo punonjës.



- Zyra Vendore Lezhë ka nën mbikëqyrje 65 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Elbasan ka nën mbikëqyrje 80 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Korçë ka nën mbikëqyrje 91 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Gjirokastrë ka nën mbikëqyrje 73 të dënuar për çdo punonjës.

Duke ju referuar statistikave, gjatë muajit Maj 2011 kanë përfunduar periudhën e mbikëqyrjes 57 të dënuar. Shtesa për periudhën 01-31 Maj 2011, prej 235 të dënuarish nën mbikëqyrje, rrit dhe ngarkesën e punës për specialistët.

### 3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ.

Statistikat për periudhën 01.06.2009 - 31.05.2011, për secilin lloj dënimi alternativ, për të dënuarit e mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës, janë si më poshtë:

- 2726 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP "pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë", shifër kjo e barabartë me 78.33 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 75 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP "qëndrim në shtëpi", shifër kjo e barabartë me 2.16 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 365 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP "Lirim me kusht", shifër kjo e barabartë me 10.49 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 313 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP "Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik", shifër kjo e barabartë me 8.99 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 1 person është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP "gjysëm-liria", shifër kjo e barabartë me 0.03 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

Këto të dhëna pasqyrohen më poshtë, në Tabelën 2.

**Tabela 2: Numri i të dënuarëve sipas llojeve të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykata për periudhën 01.06.2009 – 31.05.2011.**

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Nr. TOTAL	TOTALI në %
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	2726	78.33%
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	75	2.16%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	365	10.49%
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	313	8.99%
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	1	0.03%
TOTALI		3480	100%

Për periudhën 01.06.2009 – 31.05.2011 numri i të dënuarëve me “punë në interes publik” është **313**, ndërsa pas përfundimit të këtij dënimi për 211 të dënuar, Shërbimi i Provës ka nën mbikëqyrje **102** të dënuar.

#### **4. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.**

Konkretisht për periudhën **01-31 Maj 2011**:

- ❖ Janë kërkuar nga gjykatat **71** raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ Janë kërkuar nga prokuroritë **37** raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur **235** urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët **44** urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar mbikëqyrja për **57** të dënuar me dënime alternative.



Ndërsa në total volumi i punës së Shërbimit të Provës për periudhën 01.06.2009 – 31.05.2011 jepet si më poshtë:

- ❖ janë kërkuar nga gjykata 1398 raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ janë kërkuar nga prokuroritë 714 raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur 3480 urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët 554 urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar procesi i mbikëqyrjes për 424 të dënuar.

## II. Bashkëpunimi me partnerët

### - *me OJF-të dhe partnerët.*

- Gjatë muajit Maj 2011 ka vazhduar normalisht bashkëpunimi i Zyrave Vendore me OJF-të, sipas Marrëveshjeve që kemi lidhur me to, për trajtimin e rasteve të mbikëqyrjes për të dënuarit me dënime alternative.
- Në lidhje me ecurinë e Projektit të Binjakëzimit me Shërbimin e Provës Britanik, (AL 09 IB JH 01), “Mbështetje për Shërbimin e Provës dhe Alternativave të Dënimit me Burgim”, gjatë muajit Maj 2011 u zhvillua një trajnim në DPSHP, në lidhje me komponentët e projektit, si dhe për çështjet që kanë të bëjnë me të. Ky trajnim u zhvillua në datat 30 Maj - 03 Qershor 2011, ku morrën pjesë 8 punonjës nga Zyrat vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës. Ky trajnim me temë “Planifikimi Dënimit dhe Mbikëqyrjes” u zhvillua nga dy eksperte britanike me përvojë, Znj. Sally Lester dhe Znj. Sandra Fieldhouse.

### - *me organet e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor*

- Për sa i përket bashkëpunimit me Policinë e Shtetit theksojmë se ky bashkëpunim ndërmjet Zyrave Vendore me Komisaritet dhe Drejtoritë e Policisë në qarqe, ka qenë mjaft i mirë dhe frytdhënës, sidomos për

gjetjen dhe njoftimin e personave për të cilët nuk ka pasur adresa të sakta, në urdhërat e ekzekutimit të prokurorive.

- Po ashtu me pushtetin vendor, ka vazhduar bashkëpunimi i mirë i Zyrave vendore me ato komuna dhe bashki me të cilat janë lidhur memorandumet e bashkëpunimit.

Ndërkohë që vazhdon puna dhe korrespondenca për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me bashkitë dhe komunat e tjera.

### III.-Problematika e punës.

#### - *Zyrat e reja Vendore dhe ngarkesa.*

Gjatë muajit Maj 2010 kemi vazhduar me intensitet menaxhimin e punëve për sistemimin në ambiente normale pune, të zyrave vendore të Shërbimit të Provës, si dhe të sigurimit të infrastrukturës për to, me qëllim mirëfunksionimin e aktivitetit të këtyre zyrave vendore.

Sikurse ju kemi bërë me dije dhe në kërkesë-propozimin tonë me nr. 88 Prot., datë 13.01.2011, për ndryshimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës, si dhe në Raportin Vjetor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2010, dërguar me tonën nr. 378, datë 28.02.2011, problemi kryesor del hapja e zyrave të reja vendore me vendodhje në të gjitha rrethet gjyqësore ku nuk janë ngritur ende, si dhe ndryshimi i strukturës dhe shtimi i organikës së Shërbimit të Provës, me qëllim administrimin dhe ushtrimin e funksioneve në mënyrën e kërkuar nga ligji dhe arritjen e standardeve të parashikuara në Strategjinë Sektoriale të Drejtësisë dhe SKZHI-së, për Shërbimin e Provës, ku një nga indikatorët është dhe raporti i numrit të dënuarve që mbikqëqyren mesatarisht për një specialist të Shërbimit të Provës, përkatësisht 35-40 të dënuar /specialist.

Jemi në pritje të hapjes së 4 Zyrave të reja Vendore me vendndodhje në Kukës, Mat, Berat dhe Vlorë, të cilat sipas parashikimeve në Plan veprimet për Shërbimin e Provës dhe raportimeve në dokumentat strategjike për institucionet e BE-së, këto zyra duhej të hapeshin brenda muajit Maj.

Mjafton të përmendim se deri tani janë në mbikqëqyrje nga institucioni ynë 3056 të dënuar, ose mesatarisht **102 të dënuar për çdo specialist**, numër i cili vazhdon të rritet, dhe që është shumë më i lartë se standartet e vendeve



europiane, pa shtuar këtu faktin se punonjësit tanë deri më tani kanë hartuar mesatarisht edhe **70 raporte vlerësimi për specialist**, sipas kërkesave të gjykatave dhe prokurorive, gjë që e bën të papërballueshme ngarkesën e punës.

Duke shpresuar se kemi dhënë një analizë që pasqyron me objektivitet punën e kryer, si dhe një paraqitje të problematikës themelore nga Shërbimi i Provës, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARBEN SEFGJINI**

